



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 97, Datë 12.05.2025

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE PËR SHQYRTIMIN E  
KËRKESËS SË SHOQËRISË “GREEN ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI  
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1172/17 prot., datë 07.05.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij Aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

**1. Paraqitja e Kërkesës për Licencim**

- Shoqëria “GREEN ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1172 prot., datë 20.02.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

**2. Fillimi i Procedurës së Licencimit**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 53, datë 03.03.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- Në datat 04.03.2025 dhe 05.03.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit.
- Deri më datë 13.03.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të jetë paraqitur asnjë.

**3. Vlerësimi i dokumentacionit dhe Kërkesa për Seancë Dëgjimore**

- Me shkresat nr. 1172/4 prot. dhe nr. 1172/5 prot., datë 06.03.2025, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 53/2025 dhe zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s për sqarimin

e dokumentacionit të munguar, si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës dhe për zhvillimin e seancës dëgjimore, me qëllim marrjen e qëndrimit të saj lidhur me zbatimin e detyrimeve të shoqërisë në drejtim të afateve të ndërtimit/vënies në punë të centralit dhe/ose vlefshmërinë e kontratës.

- Në seancën dëgjimore të zhvilluar në ERE më datë 13.03.2025, mori pjesë vetëm përfaqësuesi i shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k., ndërsa nuk u paraqitën përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Gjatë seancës, shoqërisë iu sqarua dokumentacioni i munguar apo i plotësuar pjesërisht, i cili ishte njoftuar më herët edhe me shkresën nr. 1172/4 prot., datë 06.03.2025, dhe nga përfaqësuesi i shoqërisë u mor angazhimi për dorëzimin e tij. Në vijim, me qëllim përkujtesën e detyrimeve të lëna në seancë, shoqërisë iu dërgua një e-mail më datë 26.03.2025, i protokolluar në ERE me nr. 1172/6 prot. Shoqëria, me e-mailin e datës 07.04.2025, konfirmoi se ndodhet në fazën e mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar dhe se do ta dorëzojë atë pranë ERE-s në ditët në vijim.

#### **4. Zgjatja e vendimmarrjes së bordit**

- Në vijim të e-mailit të shoqërisë, datë 07.04.2025, me anë të të cilit është kërkuar kohë shtesë për depozitimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit, me vendimin nr. 65, datë 07.04.2025, bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes.
- Në vijim të korrespondencës me shoqërinë, përmes shkresave të protokolluara nr. 1172/10 prot., datë 09.04.2025, nr. 1172/14 prot., datë 30.04.2025 dhe nr. 1172/16 prot., datë 02.05.2025, vlerësohet se mbetet ende për t’u sqaruar qëndrimi i MIE-s lidhur me zbatimin e detyrimeve të shoqërisë në drejtim të afateve të ndërtimit dhe/ose vënies në punë të centralit, si dhe vlefshmëria e kontratës. Po ashtu, mbetet për t’u dokumentuar mbështetja financiare nga banka, e shoqëruar me formatin respektiv të korrespondencës zyrtare me Bankën.

#### **5. Shtyrja e Afatit të Vendimmarrjes**

- Referuar nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Green Energy” sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 MW.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve, duhet të depozitohet në ERE qëndrimi i MIE-s lidhur me zbatimin e të afateve të ndërtimit dhe/ose vënies në punë të centralit nga shoqëria, si dhe mbështetja financiare sipas formatit respektiv të bankës.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GREEN ENERGY” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**